



Përmbledhje e Vërejtjeve dhe Rekomandimeve
ANALIZA E SHPENZIMEVE 2023 -2025
FAZA I

KOMISIONERËT PUBLIKË

A. Lista e Programeve

1. Veprimtaria e komisionerit publik

B. Komente të Përgjithshme

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.
2. Janë paraqitur të gjitha raportet e kërkesave buxhetore nga institucioni në përputhje me pikën 7 të udhëzimit plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm nr. 9, datë 28.02.2022.
3. Relacioni shoqërues, në zbatim të përcaktimit të pikës 4 të udhëzimit nr. 8/2021 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, është paraqitur.
4. Institucioni ka respektuar në total tavanin e alokuar dhe shpërndarjen sipas programeve në përputhje me VKM-në nr. 130, datë 02.03.2022 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

C. Analiza e Kërkesave Buxhetore

Në relacionin shoqërues, paraqiten parashikimet buxhetore, të detajuara sipas zërave përkatës, brenda taveve të miratuara. Formatet janë plotësuar në përputhje me udhëzimin e sipërcituar.

Programi “Veprimtaria e komisionerit publik”

C.1 Formulimi i Qëllimit/Objektivave/Treguesve të Performacës

- Formulimi i Qëllimit të Politikës së këtij programi është realizuar përgjithësisht mirë. Është evidentuar një tregues performance në nivel qëllimi “Numër ankimesh ose mosankimesh të

publikuara brenda afatit ligjor”. Treguesi është plotësuar me vlerën bazë dhe me vlerat e parashikuara.

- Objektivi i politikës së programit është formuluar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me qëllimin e politikës. Është evidentuar një tregues performance në nivel objektiv i cili është plotësuar me vlera.
- Gjykojmë se për programin “Veprimtaria e komisionerit publik” duhet të shtohen treguesit e performancës, me qëllim që këta tregues të identifikojnë një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre.

C.1 Kërkesat shtesë të paraqitura në Relacionin Shpjegues

- KP ka paraqitur kërkesë shtesë në zërin “Shpenzime personeli (600+601)” në vlerën 8 milionë lekë për vitin 2023, pasi janë marrë në konsideratë efektet shtesë të miratuara me vendimin e Kuvendit nr. 37/2022, në të cilin përcaktohet dhënia e 10% të shtesës për funksion për punonjësit administrativë, dhënia e pagesës shtesë për shkak të vështirësisë në punë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor si dhe riklasifikimi i pagave për 3 specialistë të Njësisë Administrative. Lidhur me sa më sipër shprehemi se kërkesa juaj do të shqyrtohet me prioritet si rrjedhojë e nevojës së financimit të efekteve financiare në zbatim të VKM-së nr. 37/2022.
- KP ka paraqitur kërkesë shtesë në zërin “Shpenzime operative (602)” për vitin 2023, në vlerën 2 milion lekë. Në kërkesën shtesë janë përlllogaritur kostot për sigurimin e jetës dhe shëndetit të Komisionerëve Publik si dhe rishikimin e fondeve të parashikuara për blerjen e mallrave dhe shërbimeve për shkak të rritjes së çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.

ZËRI	<i>Në 000/ lekë</i>
	Viti 2023
Shpenzime personeli (600+601)	8.100
Shpenzime operative (602)	2.100
Total	10.200

Kërkesa për fonde buxhetore shtesë për vitin 2023 është në vlerën totale 10.2 milionë lekë për shpenzime korrente.

D. Konkluzione

Për të përmirësuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm, institucioni duhet të:

- Për programin “Veprimtaria e komisionerit publik” qëllimi dhe objektivi janë formuluar saktë, si dhe treguesit e performancës janë plotësuar me vlerat përkatëse.
- Sugjerojmë rishikimin e përshkrimit të të gjithë produkteve kapitale, me qëllim që përshkrimi të jetë më i detajuar se emërtesa e produktit.